| NJOFTIM PUNËSIMI | |
|---|---|
| **Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK** | Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësojë për dy vende pune:**Zhbllokues Mirëmbajtje Rrjeti UN në Njësinë Operative Durrës** nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri zbaton detyrat dhe urdhrat e punës të dhëna nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura i NjO-së dhe kryen procesin e punës të caktuar prej tij. |
| **Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:** | • Zbaton brenda kritereve të caktuara, të gjitha detyrat ditore që i ngarkohen nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura i NjO-së dhe raporton për realizimin e tyre.<br>• Paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura i NjO-së dhe i pajisur me veshje dhe vegla pune.<br>• Zbaton në çdo kohë, sipas udhëzimeve të eprorëve rregullat dhe masat e sigurimit teknik në punë.<br>• Njofton Përgjegjësin e Grumbullimit të Ujërave të Ndotura të NjO-së, për çdo problem që mund t'i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe ndjek urdhrat dhe udhëzimet që i jepen prej tij.<br>• Është në gatishmëri edhe pas kohës së punës dhe paraqitet në punë kur i kërkohet nga eprori për çdo rast emergjence |
| **Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:** | • Eksperienca pune të mëparshme.<br>• Librezë e Punës<br>• Certifikatë Familjare<br>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës |

<table>
<tr><td></td><td>
<ul>
<li>Dy fotografi</li>
<li>Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar</li>
<li>Dëshmi Penaliteti</li>
<li>Raporti Mjekësor</li>
<li>Vërtetim Vendbanimi</li>
</ul>
</td></tr>
<tr><td>Kushtet e punës:</td><td>
<ul>
<li>Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.</li>
<li>Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.</li>
</ul>
</td></tr>
<tr><td colspan="2">
<ul>
<li>Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 20.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.</li>
</ul>
</td></tr>
</table>